



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:077247

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05310484

P.nr.144/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Shpresa Hoxha, në lëndën penale ndaj të pandehurit, Xh.E nga fshati ..., Komuna Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.492/21 të datës 08.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, më datë. 27.12.2023 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Avdulla Abedini, të dëmtuarit dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij me autorizim, av.R. S, me dt. 29.12.2023 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 29.01.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, Xh.E nga fsh. ..., Komuna Kaçanik, i lindur më dt... nga i ati Rr... dhe e ema Q..., e gjinisë D..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar jashtë vendit, i gjendjes së dobët ekonomike, më nr. personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse në kohë të pacaktuar, pas datës 16.03.2013 e deri në vitin 2019, me dije ka përdor dokumentin e falsifikuar apo te ndryshuar, numrin e karrocerisë ... të automjetit të markës “ ... “ ngjyrë e bardhë me targa të regjistrimit ..., viti i prodhimit 1984, dhe të njëjtën veturë ia kishte shitur M. L., i cili me datë 05.10.2020 e kishte dërguar në Qendrën e Automjeteve të Kosovës “...”, në fshatin ..., Fushë Kosovë, me qëllim të legalizimit të ndërrimit të motorit me të cilin rast është refuzuar legalizimi i ndërrimit të motorit pasi që, me rastin e inspektimit të veturës nga punëtorët e kësaj qendre, kanë konstatuar se tek zona e numrit VIN-it (shasisë) ka pasur kit dhe saldim, me çka dyshohet në manipulim dhe se viti i prodhimit sipas Çertifikatës së Regjistrimit të Automjetit është ..., ndërsa i disa pjesëve të veturës është 1991, kurse nga raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, nr.... të dt.27.10.2020, është vërtetuar se numri i shtypur i karrocerisë ... është inkorporuar përmes saldimit, nuk i përket këtij automjeti, si dhe nuk është sipas standardeve EU Vid.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43, 69,70 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 550.00 € (pesëqind e pesëdhjetë euro).

Dënimi me gjobë do të ekzekutohet në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij atgjykimi, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zëvendesoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20.00 € për çdo ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 50.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i pandehuri, që të dëmtuarit M. L., nga Hani Elezit, t'i kompenzojë dëmin në shumë prej 800.00 € (tetëqind euro).

Konfor nenit 276 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet automjeti i markës "... " me targa ..., me nr. të shasisë ...

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.492/21 të datës 30.08.06.2021, të pandehurin Xh.E nga fshati ..., Komuna Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njejti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.18.01.2022, me të cilin rast i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 27.12.2023, prokurori i shtetit Avdulla Abedini në fjalën e tij deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotësime. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe ate ndëgjimit të dëshmitarit I. B., udhëheqës i Departamentit të Homologimit në Qendrën e Automjeteve të Kosovës, ndëgjimit të dëshmitarit M. L., dhe administrimit të provave materiale, si njoftimi nga QAK ... të dt. 05.10.2020, raporti i ekspertimit te Agjensisë së Kosovës për Forenzikë të dt. 27.10.2020, çertifikata mbi atestimin e automjeteve dhe makinave punuese në transportin rrugor i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë nr.281/13 i dt.16.03.2013, është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori më tutje sqaron se nga ndëgjimi i dëshmitarit I. B., u vërtetua se numri i cili ka qene i vendosur në tiketë në bagazh të veturës, ka patur mospërputhje të vitit të prodhimit të automjetit sipas librezës, me vitin e prodhimit të disa pjesëve dhe pas dyshimit të paraqitur, kanë pastruar zonën e numrit të shasisë të veturës së markës "... " me targa ..., në të cilën është vërejtur kiti dhe tegeli i saldimit të kësaj pjese, e për këtë arsye është refuzuar kryerja e

homologimit –legalizimit të ndërrimit të motorit të paraqitur nga i dëmtuari M. L. me dt. 05.10.2020. Nga ndëgjimi i dëshmitarit M. L., u vërtetua se veturën në fjalë e kishte blerë rreth dy vite me parë para datës 05.10.2020, kur edhe ishte lidhur kontrata, nga i pandehuri Xh. E, dhe për këto dy vite, nuk ka mundur ta bëjë bartjen në emrin e tij pasi që vetura ka qene e ngarkuar me peng, dhe gjate kësaj kohe, regjistrimi i veturës është bërë nga i pandehuri, ndërsa pagesat për regjistrim i ka bere vetë i dëmtuari-dëshmitari. Dëshmitari në fjalë, me qëllim të legalizimit të ndërrimit të motorit të kësaj veture e ka dërguar në Qendren e Automjeteve të Kosovës dhe të njëjtit e kanë refuzuar kërkesën e tij pasi që kanë dyshuar që ka ndërhyrje në numrin e shasisë dhe mospërputhje me veturën për të cilën bëhet fjalë.

Nga njoftimi i QAK- ..., të dt. 05.10.2020 ,vërtetohet fakti se numri i shasisë te zona e saj ka pasur kit dhe saldim është dyshuar në manipulim dhe viti i prodhimit sipas CRA-së librezës së qarkullimit është 1984 ndërsa në pjesen ku është ndërhy ka qenë e vitit 1991.

Nga raporti i ekspertimit të Agjensisë së Kosovës për Forenzikë të dt. 27.10.2020, vërtetohet fakti se në vetura e lartëcekur, numri i shtypur i karrocërisë, është inkorporuar përmes saldimit të një pllake metalike dhe nuk është sipas standarteve EU –VID, dhe pllaka-tiketa nuk i përket kësaj veture..

Nga çertifikata mbi atestimin e automjeteve dhe makinave punuese në transportin rrugor i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë nr.281/13 i dt.16.03.2013, vërtetohet se automjeti ka qenë në gjendje të rregullt duke përfshirë edhe numrin e shasisë.

Prandaj në bazë të gjitha këtyre provave personale dhe materiale të administruara gjate këtij shqyrtimi gjyqësor, prokurori konsideron se u vërtetua se i pandehuri ka kryer veprën penale, falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par. 1 te KPP-se dhe i propozon gjykatës që të njëjtin t'a shpall fajtor dhe ti shqiptoj nje sanksion penal me te cilin do te arrihet qëllimi i dënimit ne kuptim te nenit 38 te KPP-se

I dëmtuari në fjalën e tij, e ka mbështetur fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, në vlerë prej 800.00 €.

I pandehuri Xh.E, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se veturën në fjalë

e kishte blerë prej prej B. Sh., vetura e ka pasur regjistrimin ne Pejë, pastaj e ka regjistruar në Ferizaj, të njëjtën e ka mbajtur deri ne vitin 2019 duke e regjistruar pa kurrfarë problemi , prandaj dhe nuk ka patur ndonjë dyshim per automjetin, dhe të njëjtin automjet i ka shitur të dëmtuarit M. L.. Në mbrojtjen e tij i njëjti pranon se në vitin 2013, i ka bërë atestimin këtij automjeti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike Prishtinë, për shkak se kontrolla teknike nuk i kishte lëshuar vërtetimin për shkak të ndryshimit, gjegjësisht se i njëjti ishte kabriolet, ndërsa në librezë nuk ka figuru ky fakt dhe pastaj pas atestit e ka sjell te kontrolla teknike ...dhe pasi që ka kaluar në kontroll teknike, të njëjtin e ka regjistru. I pandehuri pranon se vetura në fjalë ka qenë prodhim i vitit ..., dhe se gjatë kohës sa e ka patur në posedim ka bërë disa riparime-investime, për shkak të aksidentit të i për të cilin mendon se ka ndodhur para vitit 2013, e për të cilin nuk ishte hapur ndonjë rast, meqë kishte ndodhur nga bashkëshortja e tij në oborrin e shtëpisë së tij, e si pasojë e të cilit ishte dëmtuar anësorja e majtë e parme-krilla dhe traversi, për të cilat i kishte treguar edhe të dëmtuarit, dhe kur është njoftuar nga i dëmtuari për çështjen e falsifikimit, ka qenë i habitur nga ky fakt, sepse në vitin 2013, pas atestimit, automjeti ka qenë në rregull. Megjithate ende nuk e ka kompenzuar të dëmtuarin, pasi që ka pritur vendimin e gjykatës.

I pandehuri në mbrojtjen e tij, poashtu ka theksuar se refuzimi i kontrolles teknike i ishte refuzuar pasi që i njëjti kishte bërë dy apo tri regjistrime pas blerjes së veturës, në vitin 2005, ndërsa atesti është kërkuar në vitin 2013, por megjithatë shton se vetura në fjalë është regjistruar çdo vit.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij përfundimtare deklaron se, nga provat e adminstruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i mbrojturi i tij, në vitin 2005 e ka blerë veturën e markës “...” objekt shqyrtimi, në Ferizaj në tregun e veturave nga B. Sh. nga fsh... Komuna Kamenicë, ne momentin e blerjes së veturës e njëjta ka qene me regjistrim te Pejës, dhe i mbrojturi i tij, ka shkuar edhe ne Qendren e Rejistrimit të Automjeteve në Pejë, ku edhe është informuar se vetura është në rregull, dhe poashtu është njoftuar se ne momentin qe t’i skadon regjistrimi, mund të tërhiqet dokumentacionin në Qendrën e lartëcekur, për t’a regjistruar në QRA Ferizaj. I mbrojturi i tij, veturën në fjalë e regjistron në emër të tij deri ne vitin 2019, kur pastaj e shet tek i dëmtuari. Në vitin 2013, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, me rastin e atestimit të automjetit në fjalë, nuk ka patur ndonjë vërejtje. Por vlen te përmendet fakti se vetura është Doganuar në Pejë , dhe sipas DUD-it, 7 numrat e fundit të VIN shasisë shënon K020342, derisa në çertifikatën e atestit të lëshuar nga Fakulteti në fjalë, shtatë numrat e fundit ndryshojnë nga numri unik doganor dhe shënon KA20342, dhe me këtë kuptohet se këto

dy prova janë kontraditore në mes vete, dhe poashtu edhe ne provën tjetër e siguruar nga Prokuroria, kontrata e shitblerjes, ku si shitës figuron Xh. R. nga fsh. ... Komuna Kacanik, ndërsa blerës B.Sh, shtatë numrat e fundit të shasisë në këtë kontratë shënojnë K020342, që do të thotë se, shtatë numrat e fundit të kësaj kontrate perputhen me Dokumentin Unik Doganor. Numri i shasisë në DUD, nga provat që gjenden ne shkresat e lëndës, sidomos nga konstatimi i Forenzikes, shtatë numrat e fundit përputhen me njëri tjetrin, pra ato të Dokumentit Unik Doganor me konstatimin e Forenzikes. Nga kjo konstatohet fakti se vetura është doganuar me këto numra të shasisë, i mbrojturi i tij e ka mbajtur gjatë këtë veturë, nuk ka patur kurfarrë njohuri se vetura është e falsifikuar te numri i shasisë, por edhe të gjitha rrethanat dhe provat tjera, tregojnë se i mbrojturi i tij nuk ka qene ne dijeni se është duke e përdor veturën me numra të shasisë të falsifikuar, andaj ne rastin konkret te i mbrojturi i tij përjashtohet përgjegjësia penale në tërësi. Këtë e bazon edhe ne nenin 390 të KPRK-së, që e rregullon Falsifikimin e Dokumenteve, për të cilën edhe është i akuzuar i mbrojturi i tij, ku përshkrimi faktik i kësaj vepre përveq tjerash thot: “ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo te ndryshuar si origjinal”. Ne bazë të të gjitha provave që janë administruar në gjykatë, Prokuroria nuk ka arrit të vërtetojë asnjë fakt se i mbrojturi i tij, e ka dit apo ka mundur ta dijë se i mbrojturi i tij e ka përdor veturën me numër të shasisë së falsifikuar, pandaj edhe i propozon gjykatës që të mbrojturin e tij, t’a lirojë nga përgjegjësia, sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale .

I pandehuri e mbështet ne tërësi fjalën perfundimtare të mbrojtësit te tij duke theksuar se nuk ka diqka tjetër për të shtuar .

Gjykata ne shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve: I. B. dhe M. L., kontrata mbi shitblerjen e automjetit e lidhur në mes të pandehurit Xh.E dhe M. L. me numër te referencën ref. ... te dt. 05.10.2020, Njoftimi nga QAK-se .. i dt. 05.10.2020, Çertifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit në emër të pandehurit, Deklaracioni unik për automobila me nr. 010592 të dt. 28.03.2003, Çertifikata mbi atestimin e automjeteve dhe makinave punuese ne transportin rrugor të lëshuar nga UP –Fakulteti i Ingjinjeris Mekanike Prishtinë me nr. 281/13 i dt. 16.03.2013, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve i dt. 08.10.2020, urdhëresa për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve PPR-156/20 e dt. 14.10.2020, leja e qarkullimit të veturës CRA-se ..., raporti i ekspertimit të Agjensisë së Kosovës për Forenzikë i dt. 27.10.2020.

Nga deklarata e dëshmitarit I. B., gjykata vërtetoi se, me rastin e atestimit të automjetit në fjalë, në Qendrën e Automjeteve të Kosovës, ku dëshmitari ka qenë udhëheqës i Departamentit të Homologimit, është vërtetuar se numri i shtypur i karrosierisë: ..., është inkorporuar përmes saldimit të një pllake metalike dhe nuk është sipas standardit EuVID, dhe kjo është konstatuar pas pastrimit në zonën e nr. të shasisë, ku vërehej sasia e kitit dhe tegeli i saldimit, për çka të dëmtuarit i është dhënë njoftimi për të vazhduar procedurën në polici.

Nga deklarata e dëshmitarit Mergjan Luma, gjykata vërtetoi se, i njëjti e kishte blerë veturën në fjalë nga i pandehuri me çmimin prej 800.00 €, të cilën e kishte vozitur me autorizim, dhe dy herë e kishte regjistruar në emër të të pandehurit, deri me dt.05.10.2020 kur formalisht edhe është lidhur kontrata me të pandehurin dhe se i dëmtuari nuk ka mundur që t'a bart veturën në emrin e tij, meqë e njëjta ishte e ngarkuar me peng . Po nga kjo deklaratë gjykata vërtetoi se pasi që i dëmtuari kishte bërë disa renovime në veturën në fjalë, e kishte dërguar në QAK ...-Fushë Kosovë, për të bërë atestimin e motorit, dhe aty është njoftuar se automjeti është i falsifikuar, ku te nesërmen ishte takuar në Hani Elezit me zyrtarë policorë të Ferizajit, të cilët e kanë shiquar automjetin në fjalë, i kanë treguar fotografitë dhe i kanë treguar për dyshimin se numri i shasisë është i falsifikuar dhe vetura i është sekuestruar. Po nga kjo dëshmi gjykata poashtu vërtetoi se , i dëmtuari deri më tani nuk është kompenzuar nga i pandehuri për dëmin e shkaktuar, duke pritur që të përfundojë gjykimi për këtë çështje.

Fakti se shitblerja e automjetit me kontratë ishte realizuar me dt.05.10.2020, u vërtetuan edhe nga kontrata mbi shitblerjen e automjetit e lidhur në mes të pandehurit Xh. E dhe M. L. me numër të referencës ref. ... te dt. 05.10.2020.

Nga njoftimi nga QAK-se Euro Lab i dt. 05.10.2020, gjykata vërtetoi se, kjo qendër kishte refuzuar atestimin për ndërrim të motorit për automjetin në fjalë, për shkak se tek zona e numrit të VIN-it, ka kit dhe saldim prandaj dyshohet për manipulim dhe për shkak se viti i prodhimit sipas CRA-së është 1984 ndërsa i disa pjesëve 1991.

Nga çertifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit në emër të pandehurit, gjykata vërtetoi se në vitin 12.06.2012 është bërë kontrolli teknik i këtij automjeti në Qendrën e Kontrollimit Teknik ... në Kaçanik, në bazë të të cilës viti i prodhimit të automjetit është viti 1984 dhe me të cilën është konfirmuar rregullsia teknike e këtij automjeti.

Nga deklaracioni unik për automobila me nr. 010592 të dt. 28.03.2003, poashtu vërtetohet se automjetit në fjalë i është paguar taksa doganore me dt.25.10.2000, e konfirmuar si e rregullt, me dt.28.03.2003, dhe vërtetohet se viti i prodhimit të automjetit në fjalë është 1984.

Çertifikata mbi atestimin e automjeteve dhe makinave punuese ne transportin rrugor të lëshuar nga UP –Fakulteti i Injinerisë Mekanike Prishtinë me nr. 281/13 i dt. 16.03.2013, gjykata vërtetoi se me rastin e verifikimit të llojit të automjetit nga veturë në veturë kabriolet, automjeti ka qenë në rregull, prandaj edhe është lëshuar certifikata në fjalë.

Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve i dt. 08.10.2020, urdhëresa për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve PPR-156/20 e dt. 14.10.2020, gjykata konstatoi se automjeti në fjalë, së bashku me librezën dhe një qels, janë sekuestruar përkohësisht.

Nga librezja e qarkullimit të veturës CRA-se 0973448, gjykata vërtetoi se automjeti në fjalë është çregjistruar nga i pandehuri me dt.05.10.2020, dhe se viti i prodhimit është ..., ndërtimi i automjetit është Cabriolet 2 dyer, ndërsa numri shasisë është

Derisa nga raporti i ekspertimit të Agjensisë së Kosovës për Forenzikë i dt. 27.10.2020, gjykata vërtetoi se, numri i shtypur në karroceri : ... i cili gjendet në pjesën metalike të karrocerisë mes motorit dhe parafangos, bazuar në deshifrimin e këtij numri të karrocerisë, vetura është prodhuar në Wolfsburg të Gjermanisë në vitin 1984, me rastin e shikimit vizual të numrit të karrocerisë dhe rreth tij, është vërejtur se pjesa metalike ku është i shtypur numri i karrocerisë ... ka saldim përreth numrit. Në hapësirën rreth numrit të shtypur të karrocerisë vërehen gjurmët e saldimit dhe rrafshimit të pllakës metalike,e cila i posedon të dhënat e njëjta me numër të karrocerisë i cili është inkorporuar në veturën në fjalë, e që nuk i përket kësaj veture, derisa etiketa ngjitëse e cila është vendosur në bagazh nuk mund të lexohet. Po në bazë të konstatimit dhe mendimit përfundimtar të këtij raporti, gjykata ka vërtetuar se numri i shtypur i karrocerisë ..., është inkorporuar përmes saldimit të një pllake metalike dhe nuk është sipas standardit Eu VID, prandaj edhe konsiderohet e manipuluar.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv.

Gjykata u dha besimin provave të prezantuara sepse me të njëjtat ne mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, dhe se këto prova, pjesërisht gjejnë mbështetje edhe në vetë mbrojtjen e të pandehurit.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, ku i njëjti thot se vitin 2013, automjetit në fjalë i është bërë atesti me rastin e verifikimit të llojit të automjetit, dhe automjeti ka qenë në rregull, derisa pranon se para kësaj kohe, bashkëshortja e tij kishte patur një aksident trafiku, dhe kishte patur renovime në automjet, por jo pas vitit 2013, prandaj thot se nuk mund të ketë qenë në dijeni se numri i shasisë së automjetit gjatë kohës sa e ka përdorur ka qenë i falsifikuar. Gjykata poashtu pati parasysh edhe mbrojtjen e dhënë nga mbrojtësi me autorizim i të pandehurit, me të cilën ndër të tjera theksohet se vetura është Doganuar në Pejë, dhe sipas DUD-it, 7 numrat e fundit të VIN shasisë shënon, derisa në certifikatën e atestit të lëshuar nga Fakulteti i Injiniërsisë Mekanike Prishtinë, shtatë numrat e fundit ndryshojnë nga numri unik doganor dhe shënon KA20342, dhe me këtë kuptohet se këto dy prova janë kontraditore në mes vete. Mbrojtësi poashtu thekson se, edhe me provën tjetër të siguruar nga Prokuroria, kontrata e shitblerjes, ku si shitës figuron Xh. R. nga fsh. ... Komuna Kacanik, ndërsa blerës B. Sh, shtatë numrat e fundit të shasisë në këtë kontratë shënojnë ..., që do të thotë se, shtatë numrat e fundit të kësaj kontrate perputhen me Dokumentin Unik Doganor, me çka konstatohet fakti se vetura është doganuar me këto numra të shasisë, i mbrojturi i tij e ka mbajtur gjatë kësaj veturë, nuk ka patur kurrfarë njohuri se vetura është e falsifikuar te numri i shasisë, por edhe të gjitha rrethanat dhe provat tjera, tregojnë se i mbrojturi i tij nuk ka qene ne dijeni se është duke e përdor veturën me numra të shasisë të falsifikuar, andaj ne rastin konkret te i mbrojturi i tij përjashtohet përgjegjësia penale në tërësi.

Një mbrojtje të tillë gjykata nuk i fali besimin meqë, bazuar në shkresat e lëndës, por edhe nga vetë deklarami i të pandehurit dhe fjala e mbrojtësit, vërehet se i pandehuri, veturën në fjalë e ka blerë në vitin 2006 nga B. Sh. në Ferizaj, dhe të njëjtën e ka mbajtur deri në vitin 2018-2019 kur edhe e ka shitur tek i dëmtuari, dhe se veturës në fjalë i është bërë atesti duke verifikuar llojin e automjetit në vitin 2013, dhe me të drejtë mund të konstatohet se vetura deri në kryerjen e atestit në vitin 2013 ka qenë në rregull, sa i përket të gjitha të dhënave, përfshirë edhe numrin e shasisë, mirëpo meqë me rastin e ekzaminimit të të njëjtës veturë në vitin 2020 në QAK ..., është konstatuar se, numri i shasisë është i manipuluar, meqë tek zona e numrit të VIN-it ka kit dhe saldim, derisa viti i prodhimit sipas CRA-së është viti 1984, ndërsa i disa

pjesëve tjera është 1991, këto fakte e vërtetojnë dyshimin e Prokurorisë se vetura në fjalë është përdorur nga i pandehuri në periudhën si në dispozitiv me numër të shasisë së manipuluar.

Kjo për faktin se vetura në fjalë edhe pas vitit 2013 (pasi që i ishte bërë atesti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike) e deri në vitin 2018-19, kur është shitur tek i dëmtuari, ka qenë në posedim të të pandehurit, derisa i dëmtuari po të kishte patur njohuri se numri i shasisë është i manipuluar, është e logjikshme që i njëjti nuk do t'a kishte dërguar veturën në fjalë për atest, në QAK ... –Fushë Kosovë.

Gjykata po ashtu pati parasysh edhe pretendimin e mbrojtësit se vetura në fjalë është blerë nga i mbrojturi i tij me numër të njëjtë të shasisë si në dokumentin unik doganor por edhe në konstatimin e Forenzikës, prandaj i mbrojturi i tij nuk ka mundur të dijë se vetura është e falsifikuar dhe nuk ka mundur që të jetë në dijeni se ka përdorur veturën me nr. të shasisë së falsifikuar, por gjykata, duke patur parasysh se kur vetura në fjalë është dërguar në QAK ...Fushë Kosovë, nga kjo e fundit është konstatuar se viti i prodhimit të disa pjesëve ka qenë ... ndërsa i disa pjesëve tjera ka qenë 1991, ndërsa numri i shtypur i karrocërës ..., në veturën në fjalë ka qenë i inkorporuar përmes saldimit të një pllake metalike dhe nuk ka qenë sipas standardit Eu VID, e këtu kur kemi parasysh faktin se deri me dt.16.03.2013, kur edhe është bërë atesti lidhur me verifikimin e llojit të automjetit nga veturë në veturë kabriolet, vetura në fjalë ka qenë në rregull, numrin e shasisë por edhe vitin e prodhimit, për çka edhe është lëshuar certifikata, gjykata konstaton se ndryshimet në automjet kanë ndodhur pas datës 16.03.2013, e meqë edhe pas kësaj kohe e deri tek shitja e veturës në fjalë tek i dëmtuari, automjetin e ka poseduar vetëm i pandehuri, është e logjikshme të konstatohet se i pandehuri ka qenë në dijeni për ndërhyrjet e bëra në automjet dhe se e ka ditur se numri i shasisë së automjetit është i falsifikuar, dhe rrjedhimisht edhe ka qenë në dijeni se ka përdorur automjetin me të dhëna si në aktakuzë me numër të shasisë së manipuluar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbrojtësi i të pandehurit, i ka propozuar gjykatës, të kërkohet verifikim nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve në Pejë, se pas doganimit të kësaj veture kur është bërë regjistrimi i parë, kush ka qenë pronari i parë i kësaj veture në Kosovë, pastaj ku është shitur dhe kush e ka blerë, dhe ndëgjimin në cilësi të dëshmitarëve të B. Sh. dhe Xh. R..

Gjykata pas ndëgjimit të arsyetimit të mbrojtësit dhe ndëgjimit të prokurorit lidhur me propozimin, me aktvendim procedural e ka refuzuar propozimin e mbrojtësit për nxjerrjen e e

këtyre informatavave, dhe ndëgjimin e dëshmitarëve B. Sh. dhe Xh. R., pasi që gjykata vlerësoi se nuk është relevante administrimi i këtyre provave, meqë nga certifikata e lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (si organ kompetent në atë kohë për atestimin e automjeteve) me nr.281/13 e dt.16.03.2013 vetura në fjalë ka qenë në rregull, prandaj edhe gjykata e ka konsideruar si irelevante nxjerrjen dhe administrimin e provave që kanë të bëjnë me periudhën para datës së atestit nga fakulteti në fjalë.

Mbrojtësi poashtu i ka propozuar gjykatës që të kërkohet zyrtarisht sqarim nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në kuadër të UP-së, nëse Institucioni në fjalë, ka patur obligim që përveq verifikimit të llojit të automjetit të bëhet edhe verifikimi i nr. të shasisë, për shkak se para se t'a blejë i mbrojturi i tij automjetin nga B. Sh., nr. i shasisë ka qenë i njëjtë me nr. e shasisë i cili ka dal i falsifikuar.

Gjykata pas ndëgjimit të arsyetimit të mbrojtësit dhe ndëgjimit të prokurorit lidhur me propozimin, me aktvendim procedural e ka refuzuar propozimin e mbrojtësit për nxjerrjen e e kësaj informate, meqë bazuar në pikën 3 të certifikatës me nr.281/13 të dt.16.03.2013, i janë verifikuar të gjitha shënimet për automjetin, përfshirë edhe nr. e shasisë, dhe për faktin se sipas kësaj certifikate viti i prodhimit të automjetit në fjalë është 1984, pra në këtë rast nuk ka patur pjesë të automjetit të viteve tjera, kurse nga njoftimi i QAK-... të dt.05.10.2020 konstatohet se viti i prodhimit sipas CRA-së është ... ndërsa i disa pjesëve të automjetit është 1991, që le të kuptojë se në rastin konkret kemi të bëjmë me kombinim të pjesëve të automjeteve të viteve të ndryshme dhe për këtë gjykata vlerëson se me rastin e atestit nga Fakulteti në fjalë nuk janë evidentuar këto ndryshime, prandaj gjykata nuk e ka vlerësuar si relevante për rastin konkret që të kërkohet kjo informatë.

Nisur nga të gjitha këto fakte të vërtetuara në procedurë, gjykata vërtetoi se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se, bazuar në evidencën penale i njëjti nuk ka të evidentuara raste të tjera penale, ndërsa rrethanë të posaqme rënduese gjykata gjeti shkallën e dëmit të shkaktuar tek i

dëmtuari, i cili e kishte blerë veturën në vlerë prej 800.00€, dhe e njëjta i është sekuestruar për shkak se ka qenë me nr. të shasisë së manipuluar.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurin Xh.E , i akuzuar për veprën penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par. 1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi për konfiskimin e automjetit të markës “... “ me targa ..., me nr. të shasisë ..., është marrë konform nenit 276 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPRK-së, meqë automjeti në fjalë si i falsifikuar është send jashtë qarkullimit juridik .

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhezimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.144/21 datë 29.01.2024

Sekretarja Juridike,
Shpresa Hoxha

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.